



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE HEALTH INSURANCE FUND	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit.	FSSH
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 4 -
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	2871
Data Datum Date	20.12.19
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

 Zyra e Guvernatorit Kabinet Guvernora Governor's Office	
E Dërguar: Fondi i Sigurimeve Shëndetësore Predator: Send to:	
Data: Datum: Date:	Nr. Br. No:
20.12.2019	489-D-19

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

FONDIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

dhe

BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Handwritten signature

PASI QË, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (në tekstin e mëtejshëm: "FSSH") dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "BQK") janë pajtuar për këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (në tekstin e mëtejshëm "Marrëveshja").

DUKE QENË SE, FSSH dhe BQK (më tej referohen bashkërisht si "palët") kanë qëllime të përbashkëta, në sigurimin e transfereve bankare dhe shërbime tjera të ndërlidhura, për të mbështetur arritjen e objektivave duke vendosur standarde të larta në menaxhimin e pagesave.

SI RRJEDHOJË, palët kanë rënë dakord të thellojnë bashkëpunimin e tyre në bazë të kësaj marrëveshje bashkëpunimi dhe të vendosin kornizat e bashkëpunimit për zbatimin e plotë të saj.

1. QËLLIMI

- 1.1 Lehtësimi i bashkëpunimit në mes të palëve në çështjet me interes të përbashkët dhe me theks të veçantë në transferin e të gjitha pagesave hyrëse dhe dalëse të FSSH-së nga Sistemi Informativ i Fondit (SIF) në Sistemin e Pagesave Ndërbankare të Bankës Qendrore (SPN) dhe anasjelltas.
- 1.2 Përcaktimi i kushteve nën të cilat FSSH dhe BQK bëjnë ndërlidhjen e drejtpërdrejt të Sistemit Informativ të Fondit me Sistemin e BQK-së për të mundësuar ekzekutimin në mënyrë elektronike të të gjitha pagesave hyrëse dhe dalëse (vendore, në mes llogarive të FSSH, ndërkombëtare etj.) nga dhe në llogarinë/llogaritë e FSSH.

2. TRANSFERIMI I TË DHËNAVE

- 2.1 Transferimi i të dhënave do të mundësohet përmes veglave/aplikacioneve që ofrohen nga SPN dhe do të jenë të qasshme vetëm nga sisteme/përdorues të autorizuar nga të dy palët.
- 2.2 Për shkëmbimin/transferin e të dhënave me sistemin e SPN-së, FSSH do të përshtat sistemin e saj në pajtim me standardet e mesazheve financiare që ofrohen nga ky sistem.

3. ZOTIMET E PALËVE

- 3.1. BQK zotohet që të sigurojë qasjen në sistemin e pagesave ndërbankare dhe FSSH zotohet që të sigurojë teknologjinë e duhur që do të shfrytëzohet për ndërlidhje ndërmjet sistemeve.
- 3.2. Palët zotohen të mbajnë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.
- 3.3 FSSH do t'i respektojë dhe do të zbatojë rregulloren e sistemit të SPN-së dhe udhëzimet operacionale përkatëse, si dhe zotohet të mos ndikojë negativisht në efikasitetin e SPN-së dhe në integritetin e transaksioneve të pagesave të dërguara dhe pranuar, shlyerjen e atyre transaksioneve apo të rrezikojë sistemin SPN.

4. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

- 4.1. Të dhënat që shkëmbehen/transferohen në mes të FSSH-së dhe BQK-së nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë transferuar.
- 4.2 Palët pajtohen që të dhënat të cilat do të shfrytëzohen nga zyrtarët e tyre janë konfidenciale dhe si të tilla do të përdoren vetëm për qëllime të kësaj marrëveshje dhe të njëjtat do të përdoren vetëm nga zyrtarët e autorizuar.
- 4.3 Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga kjo marrëveshje duhet të bëhen në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. MARRËDHËNIET E PALËVE

- 5.1 Për qëllimet e kësaj Marrëveshje asnjëra palë nuk do të ketë autorizime për të bërë ndonjë deklaratë, përfaqësim ose angazhim të çfarëdo lloji, ose për të ndërmarrë ndonjë veprim i cili do të jetë detyrues për palën tjetër, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht në këtë Marrëveshje ose të autorizuar me shkrim nga pala tjetër.

6. PËRGJEGJËSIA

- 6.1 Secila Palë do të jetë përgjegjëse vetëm për mënyrën në të cilën ajo kryen pjesë të aktiviteteve të bashkëpunimit në bazë të kësaj Marrëveshje dhe/ose ndonjë marrëveshje tjetër. Kështu që, asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë humbje, aksident, dëmtim i cili është shkaktuar ose e ka shkaktuar pala tjetër, ose nga punonjësit, konsulentët ose nën-kontraktorët e palës tjetër, në lidhje me ose si rezultat i bashkëpunimit për realizmin e aktiviteteve sipas kësaj marrëveshje.

7. AFATI DHE AMANDAMENTIMI

- 7.1 Kjo Marrëveshje mbetet e vlefshme për afat të pacaktuar, përveç nëse përfundon më herët me dakordim të ndërsjellët me shkrim të palëve.
- 7.2 Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me pajtim të ndërsjellët me shkrim të palëve. Palët mundën të ndryshojnë ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshje ose të hyjnë në aranzhime plotësuese duke përcaktuar më tej fushëveprimin e tyre.

8. HYRJA NË FUQI


- 8.1 Palët pajtohen që kjo Marrëveshje fillon së zbatuari në ditën e nënshkrimit nga Palët dhe se BQK-ja do t'i mundësojë FSSH-së testimet e nevojshme në sistemet e saj, derisa veprimet tjera do të realizohen pas funksionalizimit të FSSH-së si i pavarur nga Thesari, si organizatë jo buxhetore.
- 8.2 Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale dhe me nënshkrimin e saj, palët obligohen në zbatimin e plotë.

Për:
Fondin e Sigurimeve Shëndetësore


Fatmir Plakiqi
Drejtore

Prishtinë
14.11.2019

Për:
Bankën Qendrore të
Republikës së Kosovës


Fehmi Mehmeti
Guvernator

